



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Nr. 339 Prot

Tiranë, më 16/11/2018

URDHËR

PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË SENATIT AKADEMIK, PËRFAQËSUES I INSTITUTIT TË ANTROPOLOGJISË KULTURORE DHE STUDIMIT TË ARTIT

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, nenit 36, 37 (Senati Akademik), 38 (Funksionet e Senatit Akademik), e nenit 131, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ

1. Fillimin e procesit zgjedhor për zëvendësimin e anëtarit, përfaqësues të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në Senatin Akademik, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në datën **19.11.2018**.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve është data **19.12.2018**.
3. Në zbatim të nenit 11 (Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve pranë ASA-së në bashkëpunim me departamentet e institutit të IAKSA-së, të hartojnë listat e zgjedhësve për personelin akademik, të punësuar me kohë të plotë, **brenda datës 03.12.2018**.
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të vendosë në dispozicion të komisioneve të zgjedhjeve ambientet dhe bazën materiale të nevojshme për mirëfunksionimin e të gjithë procesit zgjedhor për zgjedhjen e përfaqësuesit të IAKSA-së në Senatin Akademik pranë ASA-së.

5. I gjithë dokumentacioni zgjedhor, duke filluar nga ky urdhër dhe deri në përfundim të procesit të zgjedhjeve të ruhet në bazë të rregullave në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.
7. Ky urdhër, të shpallet në ambientet e IAKSA-së, dhe ASA-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Marenglen Veri

